

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6452  
E shtunë, 30 tetor 2021  
çmimi 0.40 €

MSh-ja u bënë thirrje  
qytetarëve për vaksinim  
kundër Covid-19 | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TË PREMTEN ËSHTË MBAJTUR SEANCA PËR ECURINË E ÇËSHTJES NË DHOMAT E SPECIALIZUARA NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-SË, HASHIM THAÇI, KADRI VESELI, JAKUP KRASNIQI DHE REXHEP SELIMI

## AVOKATËT MBROJTËS: THEMELET E SPECIALES JANË TË MBËSHTETURA NË GËNJESHTRA



Të premten është mbajtur seanca e radhës për ecurinë e çështjes ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ben Emmerson, avokati mbrojtës i Kadri Veselit, ka thënë se Gjykata Speciale është ndërtuar mbi një raport të rrejshëm të Dick Marty. Ndërkaq avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, ka theksuar se prokuroria po bën veprime që shkojnë në dëm të krerëve të UÇK-së. Kurse avokati i Rexhep Selimit ka kritikuar prokurorinë për zvarritjen e procesit të nxjerrës së materialeve | FAQE 3

## OPOZITA NUK E PËRKRAH VETINGUN PA BASHKËPUNIM ME NDËRKOMBËTARËT | FAQE 4-5



## TË GJITHA SHKOLLAT JANË DUKE PUNUAR SIPAS SKENARIT 'RIKTHIMI' | FAQE 7

### AKTUALE




RAMA: DO TË MARRIN FUND  
PUNËSIMET POLITIKE | F. 2

YURI KIM: SHBA-JA MBËSHTET  
'OPEN BALKAN' | F. 2

QEVERIA, DORËLIRË NË PRAG TË  
ZGJEDHJEVE | F. 5

### EKONOMI



AUTORITETI KOSOVAR  
I KONKURENCËS: NUK KEMI  
MANDAT TA RREGULLOJMË  
ÇMIMIN E NDOJË PRODUKTI | F. 8

QEVERIA PREMTON PËRKRAHJE  
PËR PRODHUESIT | F. 8

### SPORT



DRITA PRET FITORE EDHE NË  
PËRBALLJEN ME MALISHEVËN | F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Yuri Kim: ShBA-ja mbështet 'Open Balkan'

TIRANË, 29 TETOR - Ambasadorja amerikane në Shqipëri, Yuri Kim, me anë të një shkrimi të publikuar në "Twitter", ka bërë me dije se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) e mbështetin plotësisht nismën e 'Open

Balkan'. Sipas saj, 'Open Balkan' duhet të jetë i hapur për të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Ajo u ka bërë ftesë Kosovës, Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës që të bëhen pjesë e nismës. Madje Kim ka shtuar se duhet të

ndërmerren iniciativa të tjera që promovojnë integrimin rajonal. "Angazhimi i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor mbetet i fortë, përfshirë mbështetjen që BE-ja t'i hapë negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e

Veriut para fundit të vitit 2021. Gjithashtu, mbështet 'Open Balkan' (e cila duhet të jetë e hapur për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor) dhe nisma të tjera që nxitin integrimin rajonal", ka shkruar Kim.



## Rama: Do të marrin fund punësimet politike



TIRANË, 29 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë takimit që ka mbajtur të premtën me kryebashkiakët, ka folur rreth analizës së performancës së sektorit ujësjellës-kanalizime. Rama ka thënë se numri i punonjësve në institucionin e ujësjellësit është sa një armatë e ndonjë shteti dhjetë herë më të madh se Shqipëria, ndërkohë që ka shtuar se ka punonjës që nuk ka lidhje me profilin, madje merr pagën pa qenë në punë. Ai ka thënë se për këtë arsye tashmë do të monitorohet

edhe rekrutimi i punonjësve që do të punojnë në këtë institucion.

Kreu i qeverisë ka theksuar se nga java e ardhshme do të zhvillohen takime me ministren dhe kryetarët e bashkive të çdo qarku për 'të vënë në jetë' planin e ri të ndryshimit. "Javën e ardhshme ministrja do të jetë qark për qark me të gjithë kryetarët dhe do të vë përpara planin si do të ndryshojmë. Një pjesë do të jenë sinergjitë e reja. Nuk mund të vazhdojmë kështu. Një pikë tjetër do të jetë

nxjerrja komplet nga duart e politikës e punësimeve në ujësjellës. Për këtë do të kërkojmë ndihmën e partnerëve tanë që të jenë monitorë të rekrutimit të burimeve njerëzore, sepse kanë investuar dhe investojnë energji, kohë dhe para. Ato para i paguajmë ne, por janë kredi me interesa shumë të ulëta, e bëjnë që të kenë sukses bashkë me ne. Të tria palët duhet të jemi aleatë për një ndryshim radikal në këtë drejtim. Dhe ndryshimi duhet të fillojë nga vetja juaj! Duhet të nisë një kapitull i ri", ka thënë Rama.

## Papa Françesku bën thirrje për përgjigje urgjente ndaj krizës klimatike

Vatikan, 29 tetor - Papa Françesku ka thënë të premtën se liderët që do të marrin pjesë në Samitin e Kombeve të Bashkuara për Klimën duhet të përgjigjen me "urgjencë" ndaj krizës klimatike. "Politikanët që marrin vendime, të cilët do të takohen në Glasgow, duhet që me urgjencë të ofrojnë përgjigje efektive ndaj krizës ekologjike", ka thënë Papa në një mesazh të transmetuar në radion e transmetuesit britanik "BBC". Ai ka thënë se kjo gjë mund të ofrojë "shpresë konkrete për gjeneratat e ardhshme". Sipas tij, secili individ mund të luajë rol në "ndryshim të përgjigjes sonë kolektive ndaj kërcënimeve të pashembullta nga ndryshimet

klimatike dhe degradimi i shtëpive tona".

Papa ka thënë më herët gjatë këtij muaji se do t'u bashkohet liderëve në samit, mirëpo më vonë është bërë me dije se Vatikan do të dërgojë një delegacion në këtë organizim, në vend të Papës.

Papa Françesku pritet të takohet me disa liderë botërorë, teksa ata marrin pjesë në Samitin e 20 vendeve më të industrializuara G20, i cili mbahet në Romë, para Samitit për Klimën. Papa do të takohet me presidentin amerikan Joe Biden, presidentin jugkorean Moon Jaein, më pas edhe me presidentin indian Narendra Modi. Samiti për Klimën do të mbahet nga 31 tetori deri më 12 nëntor.



## BE-ja: Rusia po përdor gazin si armë ndaj Moldavisë

Bruksel, 29 tetor - Shefi i diplomacisë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se Rusia është duke përdorur gazin natyror për ta shantazhuar Moldavinë, një nga kombet më të varfra në Evropë. Moldavia ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme për energji javën e kaluar, pasi kontrata e saj për gaz me kompaninë shtetërore ruse Gazprom ka skaduar në fund të muajit të

kaluar dhe të dyja palët kanë dështuar që të pajtohen për detajet e një marrëveshjeje të re afatgjatë.

Gazprom ka zgjatur kontratën deri në fund të muajit tetor, duke e rritur çmimin në 790 dollarë për metër kub për dallim nga 550 dollarë sa ishte muajin e kaluar. "Në terma globalë, rritja e çmimit të gazit në gjithë botën nuk është pasojë e përdorimit të furnizimeve me gaz si armë,

por në rastin e Moldavisë është kështu", ka thënë Borrell në një konferencë për media, bashkë me kryeministren moldave Natalia Gavrilita në Bruksel. Rusia ka kërcënuar me ndalim të furnizimeve me gaz në këtë ish-republikë sovjetike, nëse deri në fund të vitit nuk vazhdohet kontrata aktuale. Disa vëzhgues kanë thënë se Moska ka rritur çmimet si shenjë hakmarrjeje ndaj Moldavisë për zgjedhje të

presidentes pro-perëndimore Maia Sandu vitin e kaluar. "Në rastin e Moldavisë, karakteristikat politike duhet të merren parasysh. Në rastin e Moldavisë ka rritje të madhe të çmimeve, që janë të lidhura me problemet politike, andaj ka nevojë për ndihmën tonë", ka thënë Borrell. Bashkimi Evropian është zotuar se do të ndajë 60 milionë euro si ndihmë për Moldavinë.



TË PREMTEN ËSHTË MBAJTUR SEANCA PËR ECURINË E ÇËSHTJES NË DHOMAT E SPECIALIZUARA NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-SË, HASHIM THAÇI, KADRI VESELI, JAKUP KRASNIQI DHE REXHEP SELIMI

## Avokatët mbrojtës: Themelet e Speciales janë të mbështetura në gënjeshtër

Të premtën është mbajtur seanca e radhës për ecurinë e çështjes ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ben Emmerson, avokati mbrojtës i Kadri Veselit, ka thënë se Gjykata Speciale është ndërtuar mbi një raport të rrejshëm të Dick Marty. Ndërkaq avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, ka theksuar se prokuroria po bën veprime që shkojnë në dëm të krerëve të UÇK-së. Kurse avokati i Rexhep Selimit ka kritikuar prokurorinë për zvarritjen e procesit të nxjerrës së materialeve

HAGË, 29 TETOR (ER) - Të premtën në Hagë është mbajtur seanca për ecurinë e çështjes në Dhomat e Specializuara ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Këta të fundit seancën e kanë ndjekur përmes videolidhjes, derisa prezentë në sallën e Gjykatës Speciale ishin avokatët dhe përfaqësuesit e të akuzuarve. Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka shpërthyer në akuzë ndaj prokurorisë, duke theksuar se Specialja u ndërtua mbi themelet e një raporti (te Dick Marty) që është krejtësisht gënjeshtër. Sipas tij, gjithë kjo vonesë po bëhet qëllimshëm që krerët e UÇK-së të mbahen në paraburgim. "Ky është një proces i qëllimshëm që këta burra të rrinë në paraburgim. Ne nuk e dimë se kur do të fillojnë hetimet e tyre. Institucioni u

themelua për të shqyrtuar këto akuzë absurde të cilat ishin të rreme, e dimë që u sajuan nga dëshmitarë të cilët i ka paraqitur zbulimi i fshehtë serb. Prokuroria nuk ka gjetur asnjë provë mbështetëse për akuzat e saj. Themelet për ngritjen e këtij tribunali kanë qenë të mbështetura në gënjeshtër. Dick Marty shkroi një raport që përfshinte akuzat më absurde për UÇK-në", ka thënë ai. Emmerson ka theksuar se ish-krerët e UÇK-së nuk kanë bërë asgjë por vetëm kanë qenë politikanë të suksesshëm.

Ai ka thënë se e shih të pamundur që gjykimi ndaj komandantëve të UÇK-së të fillojë para fundvitit të vitit 2022. "Nuk mendoj, dhe duket absolutisht e pamundur që gjykimi të fillojë para fundvitit të 2022ës", ka thënë Emmerson. Akuzat ndaj Prokurorisë së



Specializuar të Hagës i ka vazhduar edhe avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe.

Ai ka thënë se prokuroria po bën veprime që shkojnë në dëm të krerëve të UÇK-së.

Avokati Gregory Keohe e quajti "qesharake" qasjen e prokurorisë duke vënë në dukje se prokuroria në fillim pretendonte se gjykimi të niste në verën e këtij viti. "Është shokuese për mua pozicioni i ZPS-së. Jam i sigurt që edhe ju zoti gjykatës jeni mërzitur nga kjo. Klientët tanë janë burgosur që nga viti i kaluar. Avokati koleg sapo na tha që afati fillestar ishte maji. E kuptoj zoti gjykatës që e keni shtyrë. Çfarë ka ndodhur? Që nga konferenca e parë ne kemi marrë 1 mijë e 732 dokumente teksa mbrëmë kemi marrë mbi 200

dokumente. Jam dakord me Roberts. Kur do t'i vijë fundi kësaj çështjeje? Tani na kërkohet që afati të shtyhet deri më 31 janar. Flitej që gjykimi do të fillonte në këtë vit, teksa tani dëgjojmë këtë kërkesë për shtyrje. Klienti im është në burg. Kjo është qesharake. Duhet të ketë një pikë dalëse. Ata kanë vendosur që t'i ndalojnë këta burra", ka thënë avokati Keohe.

Edhe avokati tjetër mbrojtës i Hashim Thaçit, Roberts, ka theksuar se kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj që nga koha e afatit fillestar për nxjerrjen e materialeve. "Sa herë vijmë këtu prokuroria kërkon zgjatjen e afateve kohore. Po ecim përpara por me ritëm shumë të ngadaltë. Jam i shokuar me efikasitetin e ZPS-së. Mendoj se edhe ju jeni i shokuar, po flasim për

zgjatjen e afateve ndërkohë që klientët tonë janë të burgosur. Si mund të thotë një njeri me mendje të plotë, që po bëjnë çdo gjë për të akuzuarit, ndërkohë që vazhdojnë e vazhdojnë me dokumentet e të akuzuarve tanë që po mbahen në burg. Kjo është qesharake. Duhet të ketë një pikë ndarëse. Ata kanë vendosur t'i ndalojnë këta burra. Më 31 janar thonë se do t'i marrin dokumentet dhe me siguri atëherë do të marrin kërkesë për shtyrjen e tyre deri në mars", ka thënë ai.

Po ashtu, edhe avokati i Rexhep Selimit ka kritikuar prokurorinë për zvarritjen e procesit të nxjerrës së materialeve.

Ai ka thënë se sa më shumë që po afrohen tek materialet aq më shumë po zgjatet procesi.

Më tutje, ai ka thënë se deri më tani nuk është shënuar asnjë progres në këtë proces. "I nderuar gjykatës unë vet nuk jam vrapues, por nga ana tjetër e shoh që sa më shumë të lëvizim ne aq më shumë na largohet pika e arritjes. Nga ana ime, pa u futur në detaje dhe në hollësi për materialet, mund të them se nuk kemi bërë asnjë lloj progresi. Jemi tërësisht në të njëjtën situatë dhe na u kërkua sërish që afati kohor të shtyhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm", ka thënë avokati i Rexhep Selimit.

## Osmani: Kosova ka nevojë sërish për ndihmën e shteteve mike si Portugalia

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në ditën e dytë të vizitës në Portugali, u prit nga Forcat e Armatosura të Portugalisë, në vendin prej nga forcat portugeze iu bashkëngjitën intervenimit të NATO-s në Kosovë më 1999.

Në selinë e Ministrisë së Mbrojtjes, presidentja Osmani u takua me ministrin e mbrojtjes Joao Gomes Cravinho, shefin e Forcave të Armatosura të Portugalisë, admiralin Silva Ribeiro, shefin e Forcave Detare, admiralin Mendes Calado, shefin e Ushtrisë, generalin Nunes da Fonseca dhe shefin e Forcave Ajrore, generalin Joaquim Borrego.

Në takim me ta, Osmani ka falënderuar Portugalinë, e cila më 1999 ishte pjesë e ndërhyrjes së



NATO-s në Kosovë. Ushtria e këtij shteti ka qenë pjesë e misionit të KFOR-it në Kosovë me rreth 6 000 ushtarë. Sipas saj, Kosova ka nevojë sërish për ndihmën e shteteve mike si Portugalia. "Nga pozita e komandantes supreme të Ushtrisë së Kosovës ju them se ne kemi nevojë për ndihmën tuaj sërish. Këtë herë jo për të na shpëtuar jetën, por për të ndërtuar

partneritet me ushtrinë tonë. Forca e Sigurisë së Kosovës është duke i zgjeruar kapacitetet e saj dhe është në proces të transformimit. Ushtarët tanë sapo janë kthyer nga misioni i parë paqësor bashkë me ushtrinë amerikane në Kuvajt. Kam besimin e plotë se ushtria jonë mund të përfitojë shumë nga përvoja e ushtrisë suaj. Përveç bashkëpunimit në fushën

ushtarake, në një të ardhme të afërt forcat tona dua t'i shoh krahas forcave tuaja në NATO. Kjo aleancë është synimi ynë dhe interes strategjik", ka theksuar presidentja Osmani.

Në këtë pritje, me motivacionin për kontributin për lirinë dhe paqen e Kosovës, Osmani ka dekoruar me Medaljen Presidenciale Ushtarake paqeruajtësit portugezë që morën pjesë në mision në Kosovë nga viti 1999 e deri më 2017.

Osmani ka takuar ministrin e Punëve të Brendshme, Eduardo Cabrita dhe pjesëtarë të forcave të rendit të këtij shteti, të cilët kanë shërbyer në Kosovë.

Presidentja Osmani i ka falënderuar ata për kontributin e dhënë, duke çmuar lart rolin e Portugalisë për angazhimin në Kosovë që nga viti 1999. Ajo ka vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet

të dy shteteve, duke u angazhuar për hapjen e një kapitulli të ri bashkëpunimi.

Presidentja Osmani ka theksuar se Policia e Kosovës në nivel ballkanik e ka besimin më të lartë të qytetarëve të Kosovës. Në këtë kontekst, Osmani ka kërkuar nga ministri Cabrita të shkëmbehen përvoja në mënyrë që Policia e Kosovës të përfitojë nga ajo portugeze.

Në këtë takim presidentja Osmani ka theksuar se Kosova është e orientuar qartë në rrugën e saj evropiane dhe se synim primar mbetet anëtarësimi në BE, NATO, Interpol dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Presidentja Osmani e ka falënderuar Portugalinë që është zë i fuqishëm për përkrahje të liberalizimit të vizave dhe të procesit të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

## Policia e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë bashkëpunojnë në fushën e sigurisë

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka pritur të premtën në takim drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shqipërisë, Gledis Nano. Mehmeti u ka uruar

mirëseardhje përfaqësuesve nga Policia e Shqipërisë, njëherësh i ka uruar detyrën e re Nanos si drejtor i përgjithshëm i policisë së shtetit, të cilin e ka njoftuar se Policia e Kosovës e vlerëson lart bashkëpunimin në mes të dy

institucioneve në të gjitha fushat e sigurisë dhe jo vetëm.

Ky takim ishte i karakterit njoftues, por u shfrytëzua mundësia e diskutimit edhe rreth temave me interes të përbashkët, si shkëmbimi i përvojave të

deritanishme si dhe avancimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes të dy policive të të dyja vendeve.

Palët u zotuan për vazhdim të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë, mbështetjen në

fusha specifike në mes të dy institucioneve policore, që rezultojnë në bashkërendim më të mirë në luftën e përbashkët ndaj veprimtarive kriminale, krimin të organizuar dhe atij transkufitar.



VAZHDOJNË REAGIMET NDAJ KONCEPT-DOKUMENTIT TË QEVERISË  
PËR PROCESIN E VETINGUT NË FUSHËN E DREJTËSISË

# Opozita nuk e përkrah vetingun pa bashkëpunim me ndërkombëtarët

Opozita dhe shoqëria civile kanë bërë me dije se nuk do të përkrahin një proces të vetingut në drejtësi i cili nuk bëhet në bashkëpunim me ndërkombëtarët. Zyrtarët e partive opozitare kanë deklaruar se nuk do të pranojnë një proces të tillë që nuk përkrahet nga BE-ja dhe ShBA-ja. Kurse përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë vlerësuar se vetingu nuk do të mund të zbatohet pa mbështetjen e këtyre dy partnerëve strategjikë të Kosovës

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 29 TETOR - Përfaqësuesit e subjekteve politike opozitare kanë bërë me dije se nuk do ta përkrahin procesin e vetingut në drejtësi pa bashkëpunim me Bashkimin Evropian (BE) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka deklaruar se kjo parti nuk pranon një reformë të

njëanshme në sistemin e drejtësisë. "Kemi probleme bazike me drejtësinë. Vetingu si mjet i përmirësimit të sistemit është domosdoshmëri, por si mjet i pushtetit për të kontrolluar këtë sistem kundër kundërshtarëve politikë është i pamundur dhe i padrejtë. Këtë nuk do ta lejojmë. Ne do ta pranojmë një sistem vetingu me koordinim të plotë me BE-në dhe ShBA-të", ka deklaruar Abdixhiku për "Syri.net". Ai ka thënë se tani BE-ja ka

mospajtime me propozimin e qeverisë për procesin e vetingut, duke shtuar se ShBA-ja ende nuk ka një qëndrim për këtë çështje.

Kurse shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se qeveria ka tentuar ta imponojë një proces vetingu mbi bazën e paragjykitimit dhe ngarkesave ideologjike. "Bashkimi Evropian, ashtu si partnerët e tjerë strategjikë që e kanë ndihmuar Kosovën në këtë sektor, asnjëherë nuk kanë konstatuar se vetingu nuk duhet të ndodhë. Por, para se një i tillë të vijë në shprehje, e për çfarë qeveria aktuale nuk ka as ide, as dije dhe as formulë, duhet fillimisht të vihen në jetë të gjitha instancat e tjera pararendëse që sigurojnë integritet e llogaridhënie", ka vlerësuar Tahiri. Sipas tij, kjo përpjekje e qeverisë do të jetë e dështuar. "Tendenca për ta imponuar një proces të vetingut

mbi bazën e paragjykitimit e ngarkesave ideologjike, paralelisht me dështimin për të ofruar një model të qëndrueshëm të bazuar në ligj e Kushtetutë, jo vetëm që është shpërfillje e punës dhe përpjekjeve të sistemit, por edhe një masë ideale pas së cilës është lehtë të fshihet dështimi i qeverisë në baza ditore për t'i kontribuar konsolidimit të këtij sistemi", është shprehur Tahiri.

## Pa ndërkombëtarët nuk bëhet vetingu

Shoqëria civile ka vlerësuar se mbështetja ndërkombëtare për zbatimin e reformës në drejtësi është e domosdoshme. Drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka thënë se procesi i vetingut nuk do të mund të zbatohet pa përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. Në një intervistë

dhënë gazetës "Epoka e re", Shasha ka deklaruar se realizimi i këtij procesi kërkon ekspertizë specifike e cila nuk ekziston në Kosovë. "Konsideroj se pa përkrahjen e BE-së dhe të ShBA-së vetingu nuk do të jetë i mundur të zbatohet pasi që një proces kaq i ndjeshëm dhe kompleks kërkon jo vetëm përkrahje politike nga aleatët tanë strategjikë, por edhe ekspertizë specifike e cila nuk ekziston në Kosovë", ka thënë Shasha.

Ai ka treguar se pse ka ardhur deri te kjo brengosje e BE-së për procesin e vetingut të propozuar nga Qeveria e Kosovës. Sipas Shashës, kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së dialogut në mes të institucioneve të Kosovës dhe BE-së. "Nga ana tjetër, unë jam i bindur se mungesa e harmonisë së qëndrimeve në mes të institucioneve të Kosovës dhe BE-së sa i përket vetingut vjen si

# Qeveria, dorëlibër në prag të zgjedhjeve

PRISHTINË, 29 TETOR - Buxheti i shtetit po keqpërdoret në funksion të fushatës së raundit të dytë të zgjedhjeve lokale që do të mbahen më 14 nëntor dhe kjo mund ta rrezikojë qëndrueshmërinë buxhetore, thonë Arton Demhasaj nga Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet "Çohu", dhe Pal Lekaj, anëtar i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere në Kuvendin e Kosovës. Qeveria e Kosovës, të mërkurën, më 27 tetor, ka ndarë mbi 36 milionë euro për pensione dhe skema sociale. Ndarja e këtyre mjeteve është bërë në kuadër të zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, konkretisht në kuadër të zbatimit të masës 3.2, ku thuhet "mbështetja për pensionistët dhe familjet në asistencë". Por, vlera për këtë masë në këtë pako të miratuar në muajin korrik nga Qeveria e Kosovës ishte vetëm 17 milionë euro.

Arton Demhasaj dhe Pal Lekaj në parim e përkrahin rritjen e skemave sociale për shkak të ngritjes së çmimeve, por thonë se me këto vendime po shënjestrohet pjesa më e madhe e pensionistëve që paraqiten pjesë aktive e elektoratit.

Në Kosovë çmimet e artikujve të konsumit në muajin shtator janë shtrenjtuar deri në pesë për qind dhe ky shtrenjtim ka vazhduar edhe gjatë muajit tetor.

Çmimet më të larta deri në 30 për qind vërehen te vajrat dhe yndyrat ushqimore, ndërkaq për 20 për qind të pemët dhe perimet.

## Demhasaj: Po shënjestrohen qytetarët aktivë të elektoratit

Demhasaj nga Organizata "Çohu" thotë se vetë fakti se qeveria e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje po merr vendime para fushatës së raundit të dytë zgjedhjeve lokale mund të ketë tendencë ta rritë numrin e votave



në balotazh, pasi në raundin e parë nuk ka fituar asnjë komunë.

"Shënjestër nuk janë vetëm pensionistët dhe familjet me asistencë sociale, por janë edhe familjarët e pensionistëve, është një gamë shumë e madhe e qytetarëve që preken nga ky vendim. Ata preken në aspektin pozitiv, sepse ata përfitojnë në mënyrë financiare. Por, nëse kjo përkthehet në votë, atëherë mund të llogaritet se në 30 për qind të familjeve, Lëvizja Vetëvendosja ka përfitur politikisht nga ky vendim në raundin e dytë të zgjedhjeve. Tash mbetet të shihet a do të ketë një efekt të tillë apo jo, por dyshimet ekzistojnë", thotë ai.

Në komunikatën për media të Ministrisë së Financave, të datës 27.10.2021, thuhet se kjo masë (3.2 - mbështetja për pensionistët dhe familjet në asistencë) për nga vëllimi i familjeve është më madhja që është miratuar ndonjëherë në qeveri, me afërsisht 330 mijë familje përfituese.

## Lekaj: Buxheti i shtetit në funksion të votave

Pal Lekaj, anëtar i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere në Kuvendin e Kosovës, thotë se qeveria Kurti po e keqpërdor buxhetin për shkak të balotazhit dhe po krijon jostabilitet në vija buxhetore.

Lekaj konsideron se me këto masa qeveria po i joshë votuesit me shtimin e privilegjeve, qoftë me rritjen e pensioneve, pavarësisht prej mundësive që ka arka e shtetit. Kjo, sipas tij, do të ketë kosto të lartë në planin afatmesëm dhe atë afatgjatë. "Qeveria po shpërndanë para duke mos menduar për stabilitetin buxhetor. Unë nuk e di konkretisht se ku po merren paratë, në cilat vija buxhetore. Por, në ditët në vijim mendoj se Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere duhet të bëjë një analizë për këtë çështje", thekson Lekaj.

Edhe Arton Demhasaj thotë se buxheti i Kosovës vazhdimisht ka qenë i ngarkuar me skema sociale, por vendimet e tilla po e ngufatin edhe më shumë. "Kjo ka arsyetim në aspektin ekonomik dhe financiar, pasi ka ngritje të madhe të çmimeve dhe shuma e pensioneve është shumë e vogël. Rritja ka kuptim edhe përkundër që mund të jetë ngarkesë buxhetore, por vetë fakti se vendimet po merren në mes të zgjedhjeve, kjo po i jep hije të zeza kësaj çështjeje", shton ai.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se ndarja e mjeteve bëhet në bazë të përgatitjeve dhe vlerësimeve të brendshme dhe jo nga agjendat elektorale. "Ne këto vendime i marrim duke u bazuar në përgatitjet për vendimet, jo në agjendat politike, qofshin ato elektorale apo të tjera. Gjithçka që bën do të qëllojë pas ndonjë date e para një date tjetër. Por, ky nuk është shqetësimi im", deklaroi

Kurti të premten, më 29 tetor në një konferencë për media.

Buxheti për vitin 2021 ishte paraparë të jetë mbi 2.4 miliardë euro.

Baza e politikave sociale në Kosovë përbëhet nga skema të shumta sociale dhe pensionale. Në këto kategori hyjnë mbi 420 mijë qytetarë të Kosovës dhe nga buxheti i shtetit çdo vit ndahen deri në 400 milionë euro.

Përveç 36 milionë eurove, për shtesa të pensioneve dhe familjeve me asistencë sociale, Qeveria e Kosovës të enjten, më 28 tetor, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike ka ndarë 40 milionë euro për subvencionimin e kredive për bizneset prodhuese dhe mbështetjen e eksportit.

Ministria e Financave dhe Transfereve në Qeverinë e Kosovës nuk u është përgjigjur pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" lidhur me atë se a po ngarkohet buxheti me kategoritë e shumta sociale.

rezultat i mungesës së dialogut thelbësor në mes të dy palëve. Rrjedhimisht, jam i bindur se nëse qeveria arrin të shpjegojë në mënyrë koherente dhe logjike nevojën dhe mënyrën e zbatimit të vetingut në Kosovë, atëherë do ta sigurojë edhe përkrahjen e BE-së dhe të ShBA-së", ka thënë Shasha.

Edhe Instituti i Kosovës për Drejtësi ka bërë me dije se pa partnerët ndërkombëtarë është e pamundur realizimi i këtij procesi. "IKD-ja vlerëson dhe mbetet pranë nismës së saj për ta përfshirë sistemin e drejtësisë në procesin e vetingut, si proces pa alternativë. Si i tillë, ky proces

kërkon dialog konstruktiv dhe të bazuar në fakte dhe mirëbesim në mes të partisë në pushtet në radhë të parë me partnerët ndërkombëtarë, pasuar me dialog konstruktiv dhe përbajtjesor me aktorët e sistemit të drejtësisë, partitë politike opozitare dhe komunitetet joshumicë në Kosovë", ka vlerësuar IKD-ja në një deklaratë për media.

Në raportin e progresit të KE-së për Kosovën, që u publikua më 19 tetor, është thënë se plani i Qeverisë së Kosovës që të bëjë veting të njëhershëm të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve është burim serioz i

shqetësimit. "Një proces i tillë do të duhej të konsiderohej vetëm si një masë e jashtëzakonshme pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet dhe mekanizmat ekzistues për ta siguruar integritetin dhe për ta luftuar korrupsionin e titullarëve të detyrave gjyqësore. [Procesi] do të duhej të ishte në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare si dhe me këshillat e Komisionit të Venecias", është thënë në raportin e progresit.

Kurse presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit Evropian se rivlerësimi i plotë

dhe i njëhershëm i të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve paraqet shqetësim serioz. Osmani ka deklaruar se mungesa e vetingut do të ishte shqetësim serioz, e jo realizim i këtij procesi. "Mosrealizimi i vetingut nuk u kontribuon as përpjekjeve të institucioneve të Kosovës për garantimin e sundimit të ligjit dhe as së ardhmes evropiane të vendit tonë", ka thënë Osmani. Ajo ka thënë se procesi rivlerësimi të figurës së prokurorëve dhe gjyqtarëve do të vazhdojë. "Për dallim nga ajo që konstatohet në raportin e BE-së, ky proces do të jetë i vazhdueshëm dhe

gjithëpërfshirës. Për vite me radhë raporte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare kanë konstatuar ngecjet në sistemin e drejtësisë dhe mungesën e mekanizmave adekuatë për trajtimin e këtyre ngecjeve. Me mekanizmat ekzistues nuk do të ketë mundësi të realizohen reformat e dëshiruara në sistemin e drejtësisë", ka deklaruar Osmani.

Qeveria e Kosovës më 13 tetor ka miratuar koncept-dokumentin për vetingun në drejtësi i cili është thënë se ka për synim forcimin e sundimit të ligjit.

# Haxhiu: Bashkëpunimi ndërinstytucional, rol kyç në mbrojtjen e viktimave të krimit

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 TETOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, i është përgjigjur ftesës së Institutit të Kosovës për Drejtësi për të marrë pjesë në tryezën e diskutimit lidhur me gjetjet e raportit hulumtues "Sfidat në zbatimin e ligjit për kompensimin e viktimave të krimit", e cila është organizuar me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan dhe NED-it, në kuadër të "Javës për Viktimat e Krimit". Në fjalën e saj para të pranishmëve, ministria Haxhiu e ka vlerësuar të rëndësishëm kontributin dhe bashkëpunimin me Institutin e Kosovës për Drejtësi si dhe institucionet e tjera të rëndësishme për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik dhe njohjes me të drejtat e tyre me qëllim të mbrojtjes së viktimave të krimit. Për ministren Haxhiu, dhuna në familje, veçanërisht dhuna ndaj

grave, vazhdon të jetë shqetësuese si fenomen në shoqërinë tonë. Për këtë rast, shtoi ajo, Ministria e Drejtësisë një ndër prioritetet kryesore ka adresimin e politikave ndaj dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore. Si veprim të rëndësishëm ministria Haxhiu e ka vlerësuar plotësimin e kuadrit ekzistues ligjor me synim të përfundimit të mekanizmave hetues dhe ndëshkues për kryerësit e veprave, por edhe social e mbrojtës për viktimat. Lidhur me këtë, ministria vuri theksin te Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit për të cilin janë angazhuar që t'i bëjnë ndryshimet e nevojshme duke adresuar disa çështje me rëndësi, përfshirë zgjatjen e afateve, llojet e dëmeve të kompensueshme, ristrukturimin e llojeve të dëmeve dhe shumën e kompensimit, përfshirë lartësitë e kompensimeve, po ashtu është adresuar qasja e menjëhershme



në kompensim si dhe përbërja e komisionit dhe si çështje të tilla pritet të procedohen në Kuvend të Kosovës me qëllim që të eliminohen problemet që janë identifikuar në praktikë. Ministria Haxhiu ka bërë me dije

se bashkërisht me koordinatoren nacionale kundër dhunës në familje janë angazhuar për adresimin dhe parandalimin e dhunës në familje, për çka, ka thënë Haxhiu, bashkëpunimi ndërinstytucional është tejet i

rëndësishëm për identifikimin e veprimeve serioze me qëllim të parandalimit dhe qëndrimit pranë viktimave të krimit, dhe kjo do të arrihej përmes angazhimit të të gjitha institucioneve relevante.

## Diskutohet për grantin e performancës komunale



PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Bashkëpunimi për fazën e re të grantit të performancës për periudhën 2022-2025, draftimi i ligjit të ri të bazuar në grantin e performancës komunale dhe temat e tjera me interes të përbashkët ishin pikat kyçe të diskutimit në mes të

përfaqësuesve nga Qeveria e Kosovës dhe donatorëve nga granti i performancës komunale. Në këtë takim përfaqësues nga Qeveria e Kosovës ishin zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi dhe ministri i Financave,

Hekuran Murati. Ndërsa nga donatorët të cilët bashkëfinancojnë grantin e performancës ishin ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, përfaqësues nga Ambasada e Suedisë, përfaqësues nga Ambasada e Norvegjisë si dhe nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Granti i performancës komunale ka për qëllim ta nxisë konkurrencën ndërmjet komunave në Kosovë duke ndarë mjete bazuar në meritokraci dhe kriteret e qarta. Ky grant ka marrë vlerësime të larta në raportin e progresit dhe shihet si model i cili duhet të zgjerohet dhe

institucionalizohet në kuadër të qeverisë. Programi bashkëfinancohet nga MAPL-ja, Zyra e BE-së në Kosovë, Ambasada e Zvicrës, e Suedisë dhe e Norvegjisë dhe parashihet të ketë një vlerë mbi 34 milionë euro për katër vjetet e ardhshëm, pa përfshirë asistencën teknike.

## Për tetë muaj mbi 9 000 mostra janë përpunuar për analizë mikrobiologjike në OKUK

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Nga muaji mars deri më tash, në Shërbimin e Mikrobiologjisë Klinike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, janë pranuar dhe përpunuar për analizë mikrobiologjike 9 46 mostra. Prej këtyre, janë 1 730 hemokultura, 2312 urinokultura,

776 kultura të sputumit (këlbazës), 500 koprokultura (kultura e mostres së fecesit), 623 strisho fyti dhe hunde, 682 teste serologjike, 444 strisho vaginale-cervikale dhe 334 strisho plage. "Në mesin e numrit të përgjithshëm të analizave të përpunuara, janë edhe 241 mikroskopime të mostrave të

fecesit për parazit, 408 teste rapide imunokromatografike të mostrës së fecesit për rota/adeno virus, 112 kultura të lëngut cerebrospinal (likuorit) dhe 200 mostra si punktate dhe aspirate (nga trakti respirator, abdominal etj.)", ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës.



## MSh-ja u bënë thirrje qytetarëve për vaksinim kundër Covid-19

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 TETOR - Ministria e Shëndetësisë (MSh) u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër Covid-19. Kjo ministri ka njoftuar se vaksinimi kundër Covid-19 vazhdon të jetë mënyra më e lehtë, më e sigurt dhe më efikase për t'u mbrojtur nga ky virus. "Situata epidemiologjike, relativisht e qetë, nuk përbën arsye që qytetarët që kanë marrë dozën e parë të vaksinës ta vonojnë marrjen e dozës së dytë, sepse kjo e pamundëson arritjen e mbrojtjes efikase dhe

imunitetit të plotë. Për më tepër, ata që ende nuk janë vaksinuar, nuk kanë arsye për të hezituuar, kur ekzistojnë të gjitha mundësitë për t'u vaksinuar shpejt, lehtë dhe me vakcina të sigurta. Të dhënat e raportuara nga shumë shtete tregojnë për rritje të ndjeshme të rasteve të Covid-19 këtyre ditëve gjithandej, sidomos në shtetet e rajonit", ka njoftuar MSh-ja.

Me qëllim të mbajtjes së situatës së qetë epidemiologjike në vendin tonë, ruajtjes së jetës së qytetarëve dhe parandalimin e ngarkesës së sistemit tonë



shëndetësor, në këtë kohë kur mund të shfaqen edhe raste të gripit sezonal, Ministria e Shëndetësisë u ka bërë thirrje

qytetarëve që të vaksinohen kundër Covid-19 pa asnjë hezitim.

Ministria e Shëndetësisë ka

njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 4 707 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 558 528 doza të vaksinës. Deri më sot 720 378 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Kjo ministri ka njoftuar se nga 1 958 testime, 28 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të premtën janë shënuar 25 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 317. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 431.

## Të gjitha shkollat janë duke punuar sipas skenarit 'Rikthimi'

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 TETOR - Zëvendësministri i Arsimit, i Shkencës, i Teknologjisë dhe i Inovacionit (MASHTI), Dukagjin Pupovci, ka bërë me dije të premtën se, bazuar në të dhënat e Inspektoratit të Arsimit, në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës është duke u punuar sipas skenarit 'Rikthimi', siç parasheh vendimi i qeverisë.

Pupovci ka shprehur përkushtimin e Ministrisë së Arsimit për normalizimin e plotë të procesit mësimor në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit dhe ka ftuar të gjitha palët për respektimin e masave për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19. Ai ka theksuar se, sipas këtij vendimi, procesi mësimor edukativ në institucionet e arsimit parauniversitar të të gjitha niveleve, si dhe në qendrat e qëndrimit ditor, zhvillohet me orar të rregullt dhe me prani fizike, nën mbështetjen, monitorimin dhe mbikëqyrjen aktive nga task forcat komunale dhe institucionale.

Ndërkaq procesi mësimor në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, si dhe në



institucionet aftësuese dhe të arsimit joformal, zhvillohet me prani fizike me kushtin që grupet mbi 50 persona të akomodohen në jo më shumë se 50 për qind të hapësirës.

Zëvendësministri Pupovci ka folur edhe për hapjen e konkursit për ndarjen e bursave për studentët e universiteteve publike në programet bachelor dhe master

për vitin akademik 2021-2022, ku fondi i përgjithshëm për këto bursa është 1 milion euro. Ai ka theksuar se konkursi do të jetë i hapur nga data 25 tetor deri më 8 nëntor 2021 në orën 16:00 dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët nga të gjitha fushat e studimit.

Pupovci, po ashtu, bëri me dije se MASHTI ka publikuar edhe

konkursin për bursa për nxënësit e shkollave të mesme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto bursa kanë pasur ndikim pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes së këtyre komuniteteve në arsimin e mesëm të lartë. "Konkursi do të jetë i hapur deri më 5 nëntor, ndërsa do të jepen gjithsej 500 bursa", ka deklaruar ai.

Pupovci është përgjigjur edhe në interesimin e gazetarëve në lidhje me ecurinë e procesit të përzgjedhjes së drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Prishtinës, duke thënë se inspektorati është detyruar të bëjë kallëzim penal ndaj komunës duke qenë se nuk është përfillur rekomandimi për anulim të konkursit.

## Lulzim Tafa nderohet me Çmimin e Artë "Aleksandri i Madh"

PRISHTINË, 29 TETOR - Poeti i shquar Lulzim Tafa do të nderohet në Greqi me Çmimin e Artë "Aleksandri i Madh".

Ceremonia e dhënies së Çmimit Ndërkombëtar "Aleksandri i Madh" do të mbahet më 31 tetor në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë.

Me këtë çmim që ndahet për të 37 herë me radhë,

nderohen personalitete të shquara nga mbarë bota, njerëz dhe organizata për kontributet e tyre nga fusha e letërsisë dhe arteve, shkencës, politikës dhe sportit. Ky çmim i cili është nën kujdesin e UNESCO-s jepet nga viti 1985. Poeti Lulzim Tafa do të nderohet për kontributin e tij në fushën e letërsisë dhe të mirës së përgjithshme. Kjo ngjarje e rëndësishme

kulturore do të mbahet në ishullin historik të Salaminës me praninë e autoriteteve kulturore dhe bashkiake të qytetit dhe përfaqësuesve nga UNESCO.

Lulzim Tafa është një ndër poetët kosovarë më të njohur, librat e të cilit janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Ai ka fituar shumë çmime prestigjioze ndërkombëtare të letërsisë.



# Autoriteti Kosovar i Konkurrencës: Nuk kemi mandat të rregullojmë çmimin e ndonjë produkti

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) përmes një komunikate për media ka njoftuar se ka pranuar disa ankesa lidhur me ngritjen e çmimit të disa produkteve në tregun e Kosovës, por që AKK-ja nuk ka ndonjë mandat që të rregullojë çmimin e ndonjë produkti ose shërbimi. AKK-ja thotë se vepron kur cenohet, pengohet ose shtrembërohet konkurrenca në treg. “Kohët e fundit në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (AKK) janë adresuar ankesa lidhur me ngritjen e çmimit të disa produkteve në tregun e Kosovës. Për këtë arsye, përmes kësaj deklarate për media, sqarojmë se AKK, ashtu siç është rasti me çdo institucion tjetër për mbrojtjen e konkurrencës në rajon dhe në vendet e Bashkimit Evropian, nuk ka mandat që të rregullojë çmimin e ndonjë produkti ose shërbimi. Mandati themelor i

AKK-së është mbrojtja e konkurrencës së lirë si parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe kjo nënkupton që AKK vepron kur cenohet, pengohet ose shtrembërohet konkurrenca në treg”, thuhet në njoftimin e bërë për media. Në reagim thuhet se Autoriteti i Konkurrencës mund të reagojë në ato raste kur ndërmarrjet veprojnë në mënyrë të koordinuar (pra, nëse një veprim i tillë është rezultat i marrëveshjes së tyre eksplicite, përmes formës së kartelit - marrëveshjes së ndaluar apo sjelljeve të tyre në treg - praktikës së bashkërenduar). Gjithashtu, AKK-ja mund të reagojë edhe ndaj ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese në treg dhe të cilët keqpërdorin këtë pozitë. “Natyrshisht, pas rrethanave të krijuara me çmimet e disa produkteve, AKK ka shtuar monitorimin e tregjeve për t’u siguruar që ndërmarrjet nuk janë




duke e shkelur Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përmes praktikave të

përmendura sipër. Përveç kësaj, AKK në vazhdimësi është duke avokuar përmes formave të

ndryshme që ta rritë vetëdijen e operatorëve të tregut për Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

## Qeveria premtion përkrahje për prodhuesit



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 TETOR - “Sektori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është i një rëndësie të veçantë për Qeverinë e Kosovës sepse, përveç që prodhon e siguron ushqim, krijon edhe vende pune”, ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë të përbashkët për media me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit

Rural, Faton Peci.

Në fjalën e tij para mediave, kryeministri Kurti, teksa ka listuar të arriturat në këtë fushë dhe ka shprehur mbështetjen për prodhuesit vendorë, ka theksuar se vizioni i qeverisë është për një bujqësi dhe agroindustri të qëndrueshme, që ofron ushqim të bollshëm dhe të sigurt për qytetarët e vendit.

Pas tetë vjetëve pa strategji, kryeministri Kurti ka theksuar se qeveria ka hartuar strategjinë për


bujqësi dhe zhvillim rural 2021-2027 dhe është duke e finalizuar strategjinë dhjetëvjeçare për pylltarinë 2021-2030. “Thirrjet për subvencione vitin e ardhshëm do të hapen në çerekun e parë të vitit dhe do të përmbyllen deri në mes të prillit. Investimet në këtë sektor kaq të rëndësishëm kërkojnë vëmendje dhe kohë në planifikim dhe zbatim. Ministrinë e kemi gjetur me 40 milionë euro obligime ndaj fermerëve në kategorinë e

subvencioneve të cilat i kemi adresuar. Me buxhetin e ri të qeverisë së re, vitin 2022 do ta fillojmë me zero obligime financiare karshi fermerëve. Ndërkaq përkrahja e cila për një vit kalendarik e arriti vlerën mbi 50 milionë euro, vitin e ardhshëm do të rritet për 11 milionë euro buxhet shtesë për fermerët e prodhuesit vendorë”, është shprehur kryeministri Kurti. Ai ka shtuar se si qeveri kanë aplikuar në garë ndërkombëtare, për rreth

20 milionë euro grant në programin për bujqësi globale dhe siguri ushqimore. “Qeveria është në anën e prodhuesve”, ka deklaruar Kurti.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka thënë se zhvillimi dhe implementimi i politikave të favorshme bujqësore janë prioritetet e tij, derisa përmendi gjithë punën që është bërë përgjatë tetë muajve qeverisje për të arritur deri këtu ku është sot.





## Konstandini i vogël dhe kthimi i Odiseut

**Nga: Eqrem ÇABEJ**  
(botuar më 1938)

Një nga këngët më të përmallshme të Shqiptarvet t'Italisë dhe një nga pjesët më interesante të poezisë popullore ballkanike të krahasuar është kënga e Kostandinit. Kostandini i vogël duhet të niset, tri ditë dhëndër, në luftë. Pasi merr uratën e prindërvet, ky porositi të shoqen t'a presin nëndë vjet e nëndë dit. Perënduan nëndë vjet e nëndë dit, kjo është e lirë të martohet me tjetër. E shoqja e pret; por pasi shkojnë vitet dhe ditët, kjo vete në kishë të vëjë kurorë të re. Kostandini sheh një ëndër të keqe dhe kthehet me vrap në vëndin e tij. Ay rend në kishë dhe e gjen të shoqen tek po vë kurorë me burrë tjetër. Ay e rrëmben të shoqen nga mezi i krushqvet; dhe këtu mbaron kënga e Kostandinit. "Kjo balladë", thotë Lambertzi në veprën e tij "Pralla shqiptare", ka marrë karakter ritual ndër Shqiptarët e Italisë jugore. Këndohet në çdo martesë. Pas gostisë ngrihen prej tryezës gjithë dasmorët, burra e gra, formojnë një rreth, vënë në mest të rrethit dhëndërrin me nuse, dhe duke

ardhur rreth çiftit, këndojnë këtë valle, si ç'thuhet në shqip vallja bashkë me këngën që e përcjell. Është një lavdërim poetik i besës së gruas së martuar".

Kostandini është heroi kryesor i poezisë popullore t'italoshqiptarvet. Ay është edhe sot i gjallë nëpër rrëfësat e tyre. Te Hora e Arbreshvet (Piana dei Greci) në Siqeli, dëftojnë edhe sot në kishën e vjetër të Shën Gjergjit një vënd të gropur në një gur të shkallës, ku ka shkelur thundra e kalit të Kostandinit, kur ky hyri në kishë për të marrë sërish të shoqen.

Dihet se kënga e Kostandinit të vogël ekziston me të njëjtën përmbajtje edhe në Shqipëri. I ndjeri Prof. Giuseppe Schiro, ka qënë i pari që konstatoi këtë paralelë. Në viset veriore shqiptare heroi quhet Aga Ymeri; në Lumë Imer Aga; në Toskëri Ymer Ago; në Jugë, me shqiptimin të y-së dhe të i-së n'i, Imer Ago. Në këtë emër dy pjesësh emëri i vërtetë është Ymer. Aga e Ago janë epiteti i rrjedhur nga titulli social turk aga, titull që u epej oficerave duke filluar prej majorit, si dhe disa funksionarëve civilë.

Titulli aga është i lidhur ndër me një pasuri tokësore ose me

një gjëndje ekonomike përgjithësisht të mirë të atij që e mban këtë titull aga, kjo dëshmohej edhe nga një vers i varianteve toske, ku thuhet: "Psherëtimi Ymer Agaj!".

Afërsia që lidh Kostandinin e vogël me variantet e Shqipërisë është e madhe sidomos midis varianteve italo-shqiptare dhe versioneve toske. Kjo shpjegohet nga origjina më shumë toske e Italo-shqiptarvet. Kjo afërsi është aq e ngushtë, sa nuk kufizohet në disa vija paralele të përgjithshme, por shtrihet dhe në detaje. Kështu shohim gjer verse identike të kënga e Ymer Agos.

Ndryshime themelore pra nuk gjenden as në figurën e heroit, e as në përmbajtje të këngës. Ndryshimet janë ndryshime kronologjike dhe kulture. Në emrat Kostandin i vogël dhe Ago Ymeri ose Ymer Ago pasqyrohen dy epoka të ndryshme kulture dhe influenca e tyre mbi Shqiptarët. Te emëri Ymer me titullin Aga na shohim influencën turke islame: gojëdhëna e vjetër vazhdon të jetojë, por emëri i heroit islamizohet. Heroi vesh robën osmane dhe quhet Ymer Ago. Ky emër duhet të jetë pra më i ri se Kostandin i vogël.

Përsa i përket tashti Kostandinit të vogël të Italo-shqiptarvet, Lambertzi fq. 68 v. vëren që "personi i Kostandinit është një reminiscencë e Mikros Kostandinos, Kostandinos o Mikros, d.m.th. Kostandin i vogël, i këngëve popullore greke: këtë e muarnë pra italo-shqiptarët me vete, me kalimin e tyre prej Moresë për n'Itali. Mikros Kostantinos është i biri i Perandorit Andrenikos, i kënduar shpeshherë në këngët e Digenis Akritas quhet Adrenikos dhe me që poezia popullore greke i ngarkon Kostandinin po ato aventura si dhe heroit Digenis Akritas, qëndron afër mëndsh që Kostandini i vogël i ynë të jetë një akritikotragudh i një këngë e ciklit të Digenis Akritas. Shqiptarët e Moresë që e prunë në Itali, bënë me të vërtetë disa modernizime: p.sh. Kostandinin e bëjnë të luftojë në shërbim ta Sulltanit" etj. Në duam pra të përmbledhim shkurtazi ndryshimin midia Kostandinit dhe Ymer Agos, do themi që Kostandini i Italo-shqiptarvet është një emër i sferës kulturore greko-bizantine, Ymer Agua i Shqipërisë një mër i sferës Osmane. Që ka dhe paralele të tjera midis poezisë

italoshqiptare dhe greko-bizantine, shpresoj t'a tregoj me një rast tjetër.

Zbuluam pra dy shtrete kronologjike të këngës: një më të vjetër grek-bizantin (Konstandin i vogël) dhe një më të ri turk-islamit (Aga Ymeri, Ymer Ago). Pyesim tani a mund të kënaqemi bashkë me Lambertzin, duke vënë barazimin Konstandin i vogël Digenis Akritas, d.m.th. duke shikuar burimin e këngës italo-shqiptare në poezinë popullore greko-bizantine të Kohës së Mesme. Pyesim mos është Konstandini i vogël vetëm një veshje e krishterë e një figure së vjetër të kohëve pagane, ashtu siç është Ymer Agua roba islame e heroit të krishterë. Pyesim pra në mund të gjejmë ndonjë formë më të vjetër të kësaj figure.

Për mua një lidhje e këngës së Konstandin-Ymer Agos me mitin e kthimit të Odiseut në Itakë më qe prej kohe i qartë. Tani së fundi shoh te Petrotta, "Popolo, lingua e letteratura albanese" f. 134 se i ndieri Prof. Schiro e paska bashkuar këngën e Ymer Agos me këngën greke moderne "Të njohurit". /"Hylli i Dritës" vj. 14; Nr. 2-3 Fruer-Mars 1938)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Drita pret fitore edhe në përballjen me Malishevën

Nënkampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, e zhvillon ndeshjen e radhës kundër Malishevës. Pas fitores në ndeshjen e kaluar ndaj Llapit, trajneri Ardian Nuhiu dhe futbollisti Përparim Islami kanë paralajmëruar se synim i Dritës është vazhdimi i serisë së fitoreve në elitë



**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 29 MAJ** - Skuadra e Dritës nga Gjilani e zhvillon ndeshjen e radhës në BKT Superligën e Kosovës në futboll kundër Malishevës në stadiumin "Selami Osmani - BEZI". Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, ka thënë se ka respekt të madh për kundërshtaren e radhës, derisa ka premtuar se futbollistët e drejtuar nga ai do t'i qasen me seriozitet të madh kësaj ndeshje. "Kam respekt për kundërshtaren, e cila ka treguar se mund të befasojë çdo skuadër. Kësaj ndeshje do t'i qasemi me seriozitetin më të madh. Jam i lumtur me fitoren e fundit dhe me formën e skuadrës. E kemi ndier në ndeshjen e parë se sa me vështirësi e kemi fituar takimin. Do të kërkoj nga futbollistët që të dalin te vetvetja dhe të përpiqen të luajnë mënyrën e lojës që ne kërkojmë", ka thënë Nuhiu. "Ka qenë çështje kohe

sepse kemi pasur ndryshime të shumta dhe, përveç ndryshimeve, kemi pasur edhe mungesa. Skuadra po mbrohet mirë, por na mungon krijimtaria në pjesën finale, ngaqë na kanë munguar sulmuesit. Tani më vjen mirë që ata janë kthyer, të cilët, përveç që janë kthyer, po e ndihmojnë skuadrën me gola dhe kanë marrë formën e tyre të duhur. Kam besim se nga ndeshja në ndeshje do të jemi mirë e më mirë dhe duke u njohur futbollistët me njëri-tjetrin, mendoj se do të performojnë edhe më mirë pas çdo ndeshje", ka shtuar Nuhiu.

Në konferencën për media i pranishëm ishte edhe futbollisti Përparim Islami, i cili ka thënë se Drita ka punuar gjatë gjithë javës për këtë ndeshje dhe se synim ka t'i vazhdojë rezultatet pozitive. "Ndeshjen e radhës e kemi me një ekip të ri në Superligën e Kosovës, e cila ka një grup të lojtarëve shumë të mirë, me përvojë dhe të rinj dhe

është ekip i kombinuar. Ne kemi punuar gjatë tërë javës dhe kemi marrë masat e duhura për këtë takim. Shpresoj ta japim maksimumin e t'i marrim tri pikë të plota. Në ndeshjet e fundit kemi ecuri të mirë dhe shpresoj që të vazhdojmë me rezultate sa më të mira në ndeshjet e mbetura", ka thënë Islami.

Pas njëmbëdhjetë xhirove, Drita renditet në pozitën e katërt me 19 pikë, kurse Malisheva pozicionohet në vendin e gjashtë me 12 pikë.

## BKT Superliga

**Të shtunën takohen:**  
13:00 Drita - Malisheva  
13:00 Feronikeli - Llapi  
13:00 Dukagjini - Gjilani

**Të dielën takohen:**  
13:00 Ulpiana - Ballkani  
13:00 Prishtina - Drenica

## SHKURT

### Batatina ndëshkohet 500 euro

Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka dënuar trajnerin e Llapit, Tahir Batatina, me 500 euro. Batatina është dënua për shkak se, pas përfundimit të ndeshjes Llapi - Drita, në një prononcim për media ka akuzuar gjyqtarët e ndeshjes në krye me Genc Nuzën për ndikim në rezultat të kësaj ndeshje. KD i FFK-së e ka dënua edhe futbollistin e Ulpianës, Gentian Emmini, me tri ndeshje moslojë. Me dy ndeshje është dënua futbollisti i Dukagjinit, Ilir Sylja, gjithashtu për shkak të kartonit të kuq.

### Mikaile Tmusiq, MVP i xhiros së tetë

Në mesjavë u zhvilluan ndeshjet e xhiros së tetë të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Basketbollisti më i dalluar i xhiros ishte Mikaile Tmusiq i Golden Eagle Yllit. Ai ndaj Trepçës shënoi 21 pikë, kishte shtatë kërcime, pesë asistime dhe pesë topa të vjedhur. Indeksën e kishte 33. Edhe bashkëlojtari i tij, Ardit Pepaj, zhvilloi ndeshje shumë të mirë përballë mitrovicasve me 20 pikë dhe dy kërcime. Bashkimi mundi Pejën 85:83. Më i dalluari në parket për prizrenasit ishte qendra Anton Kazarnovski me 25 pikë, katër kërcime dhe dy asistime, i ndihmuar nga Avi Toomer me 16 pikë, katër kërcime dhe shtatë asistime. Sigal Prishtina shënoi fitore bindëse ndaj RC Cola Dritës, ku u dallua kapiteni i prishtinasve, Muhamedali Janjeva, me 14 pikë, dhjetë kërcime, gjashtë asistime, pesë topa të vjedhur dhe dy bllokada.

### Bardhi, specialist për të shënuar ndaj Atleticos

Reprezentuesi i Maqedonisë, Enis Bardhi, është rikthyer këtë javë në fushat e futbollit pas më shumë se një muaji pushim dhe mbrëmë me dy penallti të realizuara nuk ka lejuar që Levante të humbasë ndaj Atletico Madridit, duke siguruar një pikë në barazimin 2-2. Levante nuk ka fituar pas 11 ndeshjeve dhe për Bardhin janë golat e parë të sezonit. Për herë të fundit që mesfushori shqiptar shënoi në La Liga ishte më 17 shkurt kundër të njëjtit kundërshtar Atletico Madridit. "Jam i kënaqur që arkëtuam një pikë. Ishim në një seri të keqe. Kjo skuadër është çdoherë e gjallë dhe këtë e dëshmuam në shumë raste. Nuk mendoj se pikët që i kemi arkëtuar deri më tani janë shumë të rëndësishme. Ne duhet t'i shohim gjërat para nesh dhe pas kësaj ndeshje ne do të ecim para dhe do të shtojmë vetëbesimin tonë. Kjo është ajo më kryesore dhe më pozitive për ne", ka thënë Bardhi.

## Kosova synon fillim të mbarë në Eskishehir

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Ishte 6 nëntori i vitit 2016 kur përfaqësuesja e Kosovës në hendboll e fitoi pikën e parë në ndeshjet zyrtare kualifikuese. Ishte faza e parë kualifikuese për "Euro 2020", ndërsa në Prishtinë Kosova u takua me Turqinë. Ndeshja kishte fund dramatik, ndërsa përfundoi 24:24. Kosova deri atëherë nuk kishte pikë të fituara sa iu takon ndeshjeve kualifikuese. Kapiteni aktual, Valon Dedaj, kishte realizuar penallti në fund për

barazimin me Turqinë në Prishtinë. Më pas rritja e "dardanëve" ka qenë graduale, por e pandalshme. Erdhi fitorja ndaj Izraelit dhe barazimi pa fat me Poloninë. Paraqitja solide ndaj Gjermanisë, barazimi me Italinë dhe fitorja bindëse me Gjeorgjinë. Rritja vazhdoi me fitoren dhe barazimin me Rumaninë dhe ndeshjet e mira me Malin e Zi. Tani është koha për të nisur një cikël të ri kualifikues, atë për Botërorin 2023. Synimi është i

qartë, një prej dy vendeve të para në grup dhe avancimi tutje. Grumbullimi bëhet të premten, ndërsa ndeshjen e parë Kosova e zhvillon të mërkurën e ardhshme, kurse sërish kundërshtar është Turqia. Këtë herë në Eskishehir. Synime të Kosovës janë pikët për ta hapur rrugën drejt fazës tjetër. Të dielën më 7 nëntor zhvillohet ndeshja tjetër në Prishtinë ndaj Belgjikës. Ndeshjet e tjera, duke përfshirë dy me Greqinë, Kosova i zhvillon në janar.



## Guardiola: Xavi është i gatshëm për Barcelonën

BARCELONË, 29 TETOR - Pep Guardiola bekon menjëherë Xavin në lidhje me zërat që e shohin atë pranë bankinës së Barcelonës. Trajneri i Manchester Cityt ka drejtuar

ekipin katalanas në periudhën më të artë, teksa në atë kohë Xavi ishte një nga elementët më të rëndësishëm të ekipit. "Nuk kam asnjë dyshim se Xavi është gati për atë vend. E njëj

futbollin, ka pasion dhe, ndoshta, më shumë përvojë se unë kur mora drejtimin e skuadrës së Barcelonës. Suksesi do të bartet nga impenjimi dhe kualiteti i futbollistëve të tij.

Ndikimi ynë në lojë është shumë më i vogël sesa e mendojnë njerëzit. Thujse gjithçka varet nga kualiteti i futbollistëve", ka deklaruar Guardiola.



## Ylli - Peja, derbi në Ligën Unike

SUHAREKË, 29 TETOR - Fundjava do të sjellë ndeshje shumë interesante në Ligën Unike, ku zhvillohet xhiro e dytë. Sfidat e parë do të zhvillohet të shtunën ndërmjet Rahovecit dhe Teutës. Vreshtarët pësuan në xhiron e parë nga Tirana, kurse duarsakët pësuan humbje nga Peja. Rahovecasit kanë bërë disa përforsime në ditët e fundit dhe shpresojnë të fillojnë me rezultate pozitive, pasi nuk e kanë nisur aspak mirë këtë edicion. Përballja e dytë do të zhvillohet ndërmjet dy skuadrave nga Shqipëria, Kamza Basket dhe Vllaznisë. Kamza në javën e parë mundi Prizrenin 16, kurse Vllaznia pësoi humbje nga Golden Eagle Ylli. Ndeshja pritet të jetë mjaft interesante. Dueli kryesor do të zhvillohet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Pejës, apo kampionit dhe nënkampionit të Kosovës dhe Ligës Unike. Skuadra nga Theranda, gjithashtu, është kampione e Ligës Unike dhe fituese e Superkupës Mbarëkombëtare. Të dyja skuadrat që e filluan me fitore kanë ambicie të mëdha në këtë edicion, andaj përballja do të jetë shumë interesante. Në përballjen e fundit do të ndeshen Tirana Neptun dhe Prizreni 16. Skuadra kryeqytetase fitoi Kupën e Federatës në Shqipëri, kurse Prizreni 16 ka fituar



Superkupën e Kosovës. Kryeqytetasit në xhiron e parë mundën Rahovecin, kurse prizrenasit pësuan nga Kamza.

### Superliga, sonte ndeshja e mbetur Trepça - Prishtina

Sonte (e shtunë) do të zhvillohet dueli i mbetur i xhiros së shtatë të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll ndërmjet Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 19:00. Skuadra mitrovicase ka pesë fitore dhe dy humbje në këtë edicion, kurse prishtinasit katër fitore dhe tri humbje. Këto dy skuadra janë me traditë në basketbollin e Kosovës dhe rivaliteti sportiv është i madh

ndërmjet tyre, andaj pritet një sfidë interesante të shtunën në "Minatori". Mitrovicasit kanë zhvilluar ndeshje shumë të mira në këtë edicion, ndërsa ishin edhe finalistë të Superkupës së Kosovës, kurse prishtinasit me një ekip të bazuar në lojtarë të rinj po japin maksimumin për t'i përmbushur synimet e klubit.

### LIGA UNIKE - XHIRO 2

Të shtunën takohen:  
17:00 Rahoveci - Teuta  
19:00 Kamza - Vllaznia

Të dielën takohen:  
17:00 Golden Eagle Ylli - Peja  
19:00 Tirana Neptun - Prizreni 16

## Rrahmani: Është ende herët të flasim për 'Scudetto'-n

NAPOLI, 29 TETOR - Mbrojtësi i Kosovës, Amir Rrahmani, e ka bërë edhe një tjetër paraqitje pozitive me Napolin në Serinë A. Skuadra e Rrahmanit e mposhti Bolognan me rezultat 3-0. "Kemi një ekip të fortë, pesë zëvendësimet janë shumë të rëndësishme në ndeshje të caktuar dhe sfidat varen nga ata. Sekretin ynë i vetëm është ekipi, mbrojtja që nga sulmi me Osimhen. Kur të gjithë punojnë e sakrifikojnë, është shumë më e lehtë. Vështirësitë që kisha në fillim? Nuk ishte e lehtë pasi nuk luajta gjashtë muaj, por kurrë s'kam dyshuar në veten time, në cilësitë e mia. Kam punuar shumë dhe besoj se kam bërë mirë në takimet e fundit", ka thënë Rrahmani. Mbrojtësi "dardan" ka folur edhe për titullin e kampionit në Itali. Ai



ka thënë se ende është shumë herët për të folur për "Scudetto". "Është shumë herët për të folur për 'Scudetto'. Kanë kaluar vetëm 11 ndeshje por, siç thashë edhe më parë, duhet të futemi mirë në çdo

ndeshje. Tani do të jetë gjithnjë e më e vështirë. E kam thënë disa herë dhe po e përsëris, Koulibaly është një nga më të mirët në botë dhe jam vërtet krenar që luaj me të", ka shtuar Rrahmani.

### SHKURT

#### Donnarumma në janar mund t'i bashkohet Juventusit

Gianluigi Donnarumma do të largohet nga PSG-ja për t'iu bashkuar Juventusit në afatin kalimtar të janarit, raportojnë mediat italiane. Vetë portieri u ka bërë me dije drejtuesve të PSG-së se dëshiron të largohet për shkak se nuk është i kënaqur me minutat që ka pasur në dispozicion këtë sezon. Ai iu bashkua ekipit francez si lojtar i lirë para fillimit të këtij edicioni pasi refuzoi rinovimin e kontratës me Milanin. Juventusit do ta transferojë si huazim Donnarummanin dhe do të ketë të drejtën e blerjes së tij. 22-vjeçari ka kontratë me PSG-në deri në vitin 2025, ndërsa këtë sezon ka luajtur vetëm pesë ndeshje.

#### Tre yje pritet të largohen nga Barcelona

Erë ndryshimesh në shtëpinë e Barcelonës. Pas shkarkimit të trajnerit Ronald Koeman, edhe disa lojtarë mund t'i thonë lamtumirë ekipit. "Sipas Sport", klubi katalanas po mendon të bëjë një spastrim për ta nisur ciklin e ri. Lojtarët që trezikojnë më shumë janë Sergio Busquets, Gerard Pique dhe Jordi Alba. Ndeshja e fundit e humbur kundër Rayo Vallecanos ka shtuar dyshimet e Barçës që duket se po mendon t'i nxjerrë në merkato tre lojtarët.

#### Mbappe: Ëndrra ime është të luaj në Lojërat Olimpike

Kylian Mbappe ka zbuluar se gjithmonë ka dashur të luajë në Lojërat Olimpike. Futbollisti në një intervistë për "L'Equipe" ka thënë se shpreson ta përmbushë ëndrrën e fëmijërisë dhe të luajë për Francën në Lojërat Olimpike "Paris 2024". "Isha duke parë Lojërat Olimpike Londër 2012 kur kuptova rëndësinë e kësaj ngjarje globale. Lojërat janë pikë referimi për sportin dhe sportistët në përgjithësi. Duhet të kem qenë 13 vjeç, isha ende i ri dhe mbaj mend emocionet para ngjarjeve në Londër", ka thënë Mbappe. "Lebron James, Kobe Bryan. Doja të shihja se çfarë bëri Usain Bolt në pistë. Të gjitha sportet e tjera, si dhe futbollin. Atëherë i thashë vetes se edhe unë dua të jem atje. Dua t'i përjetoj Lojërat e Parisit. Është një ndjenjë e brendshme sikur është fati im të marr pjesë në këtë festë të madhe në qytetin tim, në vendin tim", ka deklaruar Mbappe. Sulmuesi synon ta fitojë medaljen e artë në Lojërat Olimpike "Paris 2024", pasi tashmë ka fituar Kupën e Botës dhe Ligën e Kombeve.

#### Koulibaly largohet nga Napoli vetëm për tri klube

Manchester City, Barcelona dhe Real Madridi janë klubet ku Kalidou Koulibaly do të dëshiron ta vazhdonte karrierën. Koulibaly ishte afër largimit nga Napoli kohë më parë, por vazhdon të luajë në stadiumin "Diego Armando Maradona". Sido që të jetë, ka zëra se mbrojtësi mund të ndërrojë skuadër në janar, ose gjatë verës së vitit 2022. Ai ka treguar edhe klubet e vetme që do ta shtynin të heqë dorë nga Napoli. "Nëse vendos të largohem nga Napoli, do ta bëja për dy apo tri klube më së shumti në botë. Po flas për Cityn e Guardiols, Real Madridin dhe Barcelonën", ka thënë Koulibaly. 30-vjeçari është pjesë e Napolit që nga viti 2014. Ai deri më tani ka bërë 295 paraqitje, ka shënuar 13 gola.

## NBA 'pushtohet' nga të huajt

Në 75 vjet histori, NBA ka ndryshuar shumë. Në sezonin 1946-1947, kur luhehin ndeshjet e para, në fushë ishin vetëm pesë basketbollistë të huaj. Ndërsa në startin e këtij sezoni (2021-2022), në fushë janë 109 të huaj, që vijnë nga

39 shtete të ndryshme të botës. Kjo rritje e ndjeshme ka ndodhur për faktin se të huajt po bëhen gjithnjë e më shumë të rëndësishëm për NBA-në. Madje në tre sezonet e fundit ata kanë fituar trofeun MVP të sezonit të rregullt: Dy herë me

grekun Giannis Antetokounmpo dhe vjet me serbin Nikola Jokiq. Fakt është që 1/5 e lojtarëve që luajnë në NBA nuk janë amerikanë. Vendi me më shumë basketbollistë pjesëmarrës në NBA mbetet Kanadaja, me 18

lojtarë. Pas saj ndodhen Australia, Franca e Gjermania me shtatë përfaqësues, ndërsa Nigeria, Spanja, Serbia e Turqia kanë nga pesë basketbollistë. Skuadra kanadeze e Toronto Raptorsit është ajo që ka më shumë

joamerikanë: dhjetë të tillë edhe për faktin se është ekip kanadez. Më pas vjen Dallasi me shtatë të huaj dhe me dominojnë 2/3 nga pesë lojtarë joamerikanë siç janë Oklahoma, Atlanta, Bostoni, Denveri e New Orleansi.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih  
Poslova  
Ministry of Internal Affairs  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate  
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a



Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë:27/10/2021 me nr ref: 01/0847, Policia e Kosovës shpall:

### KONKURS

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit.

**Vendi i punës: Policia e Kosovës**

**A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kritere:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar);
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

**B. Testet:**

- Testi me shkrim;
- Testi i aftësive fizike;
- Intervista;
- Testi psikologjik;
- Kontrollimi mjekësor;
- Verifikimi i të kaluarës.

**C. Forma e aplikimit:**

Aplikimi në konkursin për zyrtarë policorë është online përmes ueb faqes zyrtare të PK-së: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) / **Shpallje/Mundësi punësimi.**

**D. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:**

- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera;
- Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime;
- Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokumenti nga pika **c** dhe **d** të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

**E. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë**

- Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat;
- Të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- Të parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të hetojë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të mbikëqyrë dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion;
- Të menaxhojnë dhe të kontrollojnë kufirin shtetëror;
- Të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- Të kryejnë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

**F. Zbatimi i vendimit të datës 27/10/2021 me nr ref: 01/0847 për zbatimin e masave të veçanta të përkohshme afirmative**

Në këtë konkurs Policia e Kosovës do të ndërmer masa të veçanta të përkohshme afirmative me qëllim të garantimit të të drejtave të barabarta gjinore, promovimit të barazisë gjinore dhe me qëllim të rritjes së përfaqësimit të zyrtarëve policorë gra në Policinë e Kosovës.

Masat e veçanta të përkohshme afirmative që do të ndërmer Policia e Kosovës do të zbatohen në procedurën e rekrutimit dhe punësimit në Policinë e Kosovës, në mënyrë që gjatë procesit të rekrutimit të zyrtarëve policorë nga të gjithë ata kandidatët që do të plotësojnë kushtet dhe kalojnë pragun e kalueshmërisë 70% përparësi do të këtë gjinia femërore.

Aplikimi për zyrtar policor bëhet online. Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë përmes ueb faqes zyrtare të Policisë së Kosovës: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) nga data **28.10.2021** deri me datën **16.11.2021**.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1554 apo 1722 si dhe në 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes se aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimeve do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

**“Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate  
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/Uprava za Ljudske Izvore PK-a

Na osnovu Zakona o Policiji, Poglavlje V, člana 44, Zakona o Radnom Odnosu Br. 03/L-212, Poglavlje II, član 8, Zakon o Ravnopravnosti Pola br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakon o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 8 i 9, tačka 1 i 2 i Odluke Generalnog Direktora:27/10/2021 pod br. ref: 01/0847, Policia Kosova objavljuje:

### KONKURS

Za prijem policijskih službenika prema predviđenim uslovima konkurisanja.

**Radno mesto: Policia Kosova**

**A. Kandidati koji apliciraju za policijskog službenika u Policiji Kosova treba da ispunjavaju sledeće uslove:**

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da je uzrasta od 18-30 godine;
- Da ima završenu srednju školu;
- Da je u dobrom fizičkom,mentalnom i emocionalnom stanju;
- Da nije kažnjavan za neko krivično delo;
- Da nema na vidno mesto tetovaže (lice, vrat, ruke)
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti;

**B. Testovi:**

- Pismeno testiranje;
- Testiranje fizičkih sposobnosti;
- Intervjuisanje;
- Psihološko testiranje;
- Lekarska kontrola;
- Provera prošlosti;

**C. Način apliciranja:**

Apliciranje na konkurs za policijske službenike je online putem službene veb stranice PK-a: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) / **Oglas/Mogućnosti za zapošljavanje.**

**D. Aplikaciji priložiti potrebnu dokumentaciju:**

- Kopja diplome za srednje visoko obrazovanje, dok za kandidate koji su završili školovanje van zemlje kopija nostrifikovane diplome;
- Dokaze za ostale kvalifikacije;
- Izvod rođenih / ekstrakt rođenih;
- Potvrda iz suda da nije kažnjavan i nije pod istragom;
- kopija lične karte ili pasoša.
- Jedna fotografija veličine (5 x 5);
- Dokumentacija iz tačke c) i d) treba da su važeće i da su izdate nakon datuma objavljivanja konkursa.

**E. Opšti zadaci i ovlašćenja Policije**

- Da zaštiti život, imovinu i da pruži zaštitu za sve građane;
- Da zaštiti osnovna ljudska prava za sve građane;
- Da sprečava rizik nad građanima i da održava javni red i mir;
- Da sprečava i otkrije krivična dela i njihove počinioce;
- Da istražuje krivična dela i njihove počinioce;
- Da nadgleda i kontroliše bezbednost u saobraćaju;
- Da menadžira i kontroliše državnu granicu;
- Da pruža pomoć tokom prirodnih nezgoda i u drugim emergentnim situacijama;
- Da obavlja druge poslove predviđene Zakonom o Policiji.

**F. Primenjivanje odluke od 27.10.2021 pod br ref: 01/0847 za sprovođenje posebnih privremenih afirmativnih mera**

Na ovom konkursu Policia Kosova preduzeće posebne privremene afirmativne mere u cilju garantovanja jednakih rodniha prava, promovisanje rodne ravnopravnosti i sa ciljem povećanja zastupljenosti policijskih službenica žena u Policiji Kosova.

Posebne mere koje će preduzeti Policia Kosova sprovođiće se u proceduri regrutacije i zapošljavanja u Policiji Kosova, na načinu da tokom procesa regrutacije policijskih službenika od svih tih kandidata koji će ispuniti uslove i prelaze prag polaganja 70% imaće prednost ženski rod.

Apliciranje za policijske službenike vrši se online. Zainteresovani kandidati mogu aplicirati putem službene veb stranice Policije Kosova: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) od **28.10.2021** do **16.11.2021**.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na brojeve telefona: 038-5080 lokal: 1554 ili 1722, kao i na tel: 038/245-184, od 09:00-15:00h.

Uspešni izabrani kandidati biće pozvani da učestvuju na gore navedenim testiranjima. Informisanje kandidata u vezi svake faze testiranja objaviće se na službenoj veb stranici Policije Kosova, na adresi: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) i na oglasnoj tabli po Regionalnim Direkcijama i odgovarajućim Policijskim Stanicama.

**“Policia Kosova služi celom narodu Kosova. Ova služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Republike Kosova i očekuje aplikacije od osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu”.**





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



29.10.2021

### Njoftim për tatimpagues

#### Transaksionet me biznese fiktive dhe biznese jo-aktive, janë të papranueshme nga ATK!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjitha bizneset, të cilat merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor, ATK nuk njeh transaksionet e realizuara me bizneset fiktive dhe biznese jo-aktive.

Transaksionet e realizuara me bizneset fiktive dhe biznese jo-aktive, gjegjësisht shpenzimet në Deklaratën e Tatimit në të Ardhura, si dhe kërkesat për kreditim të zbritshëm në një deklaratë të TVSH-së, nuk do të njihen nga ATK.

Njëherësh, ATK, ju njofton se aktivitetet e saj, do të përqendrohen te bizneset, të cilat zhvillojnë transaksione fiktive dhe te biznese jo-aktive që funksionojnë në mënyrë jo të rregullt, për të cilat do të ndërmerren masat konform legjislacionit tatimor.

ATK, ju bën thirrje të gjitha bizneseve, që para se të hyjnë në transaksione afariste të bëjnë verifikimin e bizneseve jo-aktive, të cilat i gjeni në ueb faqe [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) në linkun <https://www.atk-ks.org/portfolio/tatimpaguesit-jo-aktiv/>.

**Çdo herë kur ATK gjatë verifikimit të dokumentacionit identifikon ndonjë transaksion / faturë fiktive, pavarësisht se a është biznesi që ka lidhur transaksionin / lëshuar faturën i publikuar në ueb-faqe të ATK-së apo jo, ai transaksion / ajo faturë nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së shpenzimeve në Deklaratën e Tatimit në të Ardhura, si dhe nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së TVSH-së së zbritshme.**

**Po ashtu, për të dy bizneset, si: për biznesin i cili e ka lëshuar faturën për transaksionin fiktiv dhe biznesin që e ka pranuar faturën për transaksionin fiktiv, ATK do të ndërmerret masat e përcaktuara me Legjislacionin në fuqi.**

Është detyrë e çdo tatimpaguesi që të respektoj dhe të zbatoj dispozitat e legjislacionit tatimor të aplikueshëm.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju kontribuoni direkt në ofrimin e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore.

Administrata Tatimore e Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 29.10.2021 bënë shpallje publike për dhënie të pronës së paluajtshme me qira.

### Shpallje Publike

#### T-21-008

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e hapësirave 1. Zyre ne Terminalin Doganor.
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Periudha:	3(tre) vite me mundësi vazhdimi
Data e shpalljes:	29.10.2021
Sqarimi:	deri me 03.11.2021
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 03.11.2021 Behet në e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit:	05.10.2021 në 10:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

#### Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Certifikata e lëshuar nga Dogana e Kosoves – Agjent Doganor
3. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Vërejtje: për arsyeje të vendosjes të terminalit doganorë

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku inustrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Mishtorja Demi” Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mishtoren,thertorën për therrjen e kafshëve të trasha dhe të imëta në Z.K. Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.11.2021 në ora 11:00 në restourantin Golden Agi i cili gjendet në Magjistratën Prishtin-Ferizaj Lipjan, Kosovo, fsh. Dobratin, komuna e Graçanicës do të organizohet debat publik nga Kompania “ Mishtorja Demi” Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mishtoren,thertorën per therrjen e kafshëve të trasha dhe të imëta në Z.K. Graçanicë

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Mishtorja Demi” Sh.p.k , Prishtinë për mishtorën,thertorën për therrjen e kafshëve të trasha dhe të imëta në Z.K. Graçanicë

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Palush Maksuti Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha”.
- ▶ Xhafer Rragamaj Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- ▶ Selami Sadrija Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- ▶ Albulena Hoda Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- ▶ Rrezarta Gerqina Gjakovëshpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- ▶ Bajram Thaqi Gjakovë, shpall të pavlefshme tëftesën e plotë të SH.F.M.U. “Ukshin Miftari” nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

